



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVA

Fjalimi përshëndetës i Guvernatorit

Nëntor 14, 2023

Konferenca: Bankat, fintekët dhe bizneset: Ndërtimi i sinergjive për përshpejtimin e qasjes në financa

Organizator: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe USAID Kosova

Koha dhe vendi: 14 nëntor 2023 ora 09:30-13:00, Emerald Hotel, Prishtinë

I nderuari, z. Albertine, Drejtor i Zyrës për Rritje Ekonomike, USAID Kosovë

I nderuari, Kryetar z. Nurboja dhe Anëtar të Bordit të BQK-së

Të nderuar, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare

Të nderuar, drejtues dhe përfaqësues të bankave dhe institucioneve të tjera financiare

Shumë të nderuar përfaqësues të bizneseve

Të respektuar panelistë

Zonja e zotërinj

Kam kënaqësinë të ju përshëndes në këtë forum të bashkëorganizuar në mes të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe USAID-it me titull “Bankat, fintekët dhe bizneset: Ndërtimi i sinergjive për përshpejtimin e qasjes në financa”.

Fakti që BQK-ja është bashkëorganizatore e konferencës dhe pjesëmarrja ime sot në këtë rast, demonstroi rëndësinë që për BQK-në ka qasja në financa, përfshirja financiare, digjitalizimi i shërbimeve të pagesave dhe produkteve alternative financiare. Prandaj, edhe përputhshmëria që ka projekti i USAID IPAF me Strategjinë dhe qëllimet e BQK-së, përbën në vete një sinergji.

Jemi dëshmitar se sistemi financiar përgjatë viteve ka evoluar vazhdimisht e sidomos viteve të fundit vërehet një dinamikë më e përshpejtuar drejt digjitalizimit dhe qasjes në shërbime financiare. Nga perspektiva ekonomike, një sistem financiar efikas mbështetë zhvillimin e ndërmjetësimit financiar, të tregjeve financiare dhe ndikon pozitivisht në stabilitetin financiar.

Avancimi i shërbimeve financiare drejt transformimit të pagesave elektronike (transaksionet jo në para të gatshme) do të kontribuonte në rritjen e gjithëpërfshirjes financiare, rritjen e konkurrencës, zvogëlimin e informalitetit dhe rritjen e efektivitetit, uljen e kostos, si dhe ofrimin

e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve nga institucionet financiare, si dhe integrimin e qytetarëve tanë dhe bizneseve me rajonin dhe vendet e BE-së.

Në këtë drejtim, BQK-ja është e angazhuar:

- Të zhvillojë dhe krijojë mundësitë për qasjen në sistemin e pagesave të ofruesve të shërbimeve jobankare, rritjen e konkurrueshmërisë dhe mundësimin e posedimit të IBAN-it, për të rritur qasjen në financa, në kuadër të konceptit të "llogarisë për pagesa";
- Të zhvillojë infrastrukturën teknike për mundësimin e pagesave të shpejta 24/7, krijimin e QR Kodit kombëtar dhe standardizimin e API për ndërlidhjen e sistemeve;
- Të avancojë kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse për fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit lidhur me shërbimet e pagesave dhe të pajtueshmërisë;
- Të fuqizojë Këshillin Kombëtar të Pagesave në nivel të vendit; dhe
- Të avokojë për mundësimin e qasjes në platformat ndërkombëtare të pagesave (Paypal, Apple Pay, Google Pay, Samsung Pay, etj.) për mbështetje të e-commerce.

Andaj, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës sipas mandatit ligjor dhe përmes Strategjisë së saj është në proces të avancimit të kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse dhe infrastrukturës në fushën e shërbimeve të pagesave, në drejtim të harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, *[sikurse është Direktiva e Shërbimeve të Pagesave 2, Direktiva e Parave Elektronike dhe Direktiva e Llogarisë së Pagesave]*, PFMI dhe standardet tjera ndërkombëtare në funksion të anëtarësimit në SEPA dhe sistemet e pagesave të BE-së.

Në këtë drejtim, anëtarësimi në TIPS dhe skemën SEPA mbetet objektiv i yni strategjik, i cili do të lehtësonte tregtinë në vendin tonë dhe më gjerë, duke mbështetur rritjen ekonomike dhe forcimin e stabilitetit të sistemit financiar dhe në këtë mënyrë do të kontribuonte ndjeshëm në një sistem inovativ, efikas dhe të integruar të pagesave.

Për këtë qëllim, BQK-ja do të zhvillojë projekte me rëndësi në funksion të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, ku do të investohet në ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore dhe burimeve njerëzore. Duke investuar në këtë drejtim, do të sigurohemi se sistemet, pajisjet, njohuritë, aftësitë dhe mjetet e personelit mundësojnë transformimin dhe janë relevante dhe efektive në mbikëqyrjen e rreziqeve të teknologjive të reja dhe modeleve inovative të biznesit.

Kjo ndërlidhet edhe me planin e BQK-së për krijimin e funksionit të veçantë për mbikëqyrjen e sistemeve të informacionit apo rrezikut kibernetik për institucionet financiare, funksionit të mbikëqyrjes së praktikave të ofrimit të shërbimeve nga institucionet financiare, si dhe fuqizimin e edukimit financiar, si mjet për të pasur një trajtim korrekt dhe të drejtë të kërkesave që rrjedhin nga shërbimet e tilla.

Krahas mundësive dhe lehtësirave që paraqiten nga përdorimi i teknologjisë së informacionit, BQK-ja do të trajtoj me kujdes edhe rreziqet që paraqiten sikurse janë rreziku strategjik, reputacional, operacional, kibernetik dhe rreziku i pajtueshmërisë dhe do të punojë ngushtë edhe me institucionet akademike në realizimin e hulumtimeve dhe kërkimeve shkencore lidhur me fushën e qasjes në financa dhe gjithëpërfshirjen financiare.

BQK në kuadër të fushëveprimit rregullativ dhe mbikëqyrës, pret që industria financiare, ku bëjnë pjesë edhe institucionet financiare jobankare:

- Të kenë praktika dhe procese adekuate të menaxhimit të rrezikut në rastet e shërbimeve të kontraktuara nga jashtë (outsourcing), të cilat përfshijnë kujdesin e duhur, menaxhimin

- e rrezikut operacional, monitorimin e vazhdueshëm dhe ekzekutimin e duhur të kontratave me ofruesit e shërbimeve të kontraktuara nga palët e jashtme që përcaktojnë përgjegjësitë e secilës palë; dhe
- Të kenë parasysh faktorët që të sigurojnë vazhdimësinë e biznesit, konfidencialitetin dhe integritetin e informacionit kur kontraktojnë shërbime nga palët e jashtme, si dhe të shtojnë vëmendjen për pronësinë e jashtme dhe prejardhjet e fondeve të klientëve, përmes mekanizmave të vëzhgimit (Investor's Screening Mechanism), duke pasur parasysh rreziqet aktuale gjeostrategjike.

Më lejoni që të falënderoj USAID-in për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë BQK-së në ngritjen e kapaciteteve për fusha të ndryshme që lidhen me mandatin e BQK-së dhe sidomos për projektet që i kemi në proces lidhur fushën e qasjes në financa dhe zhvillimin e tregut të kapitalit.

Lidhur me këtë, BQK-ja e konsideron se projekti i USAID-it për Promovim të Investimeve dhe Qasjes në Financa është një mjet i rëndësishëm për të arritur realizimin e objektivave dhe Planit Strategjik, ndaj konfirmon gatishmërinë dhe mbështetjen në arritjen e qëllimeve sa zhvillimore ashtu edhe të cilësisë dhe shërbimeve financiare me përfshirje të gjerë.

Duke ju falënderuar, ju uroj punë të mbarë dhe diskutime të frytshme në këtë konferencë.

Me respekt!